



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo

Institucioni i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr.i Pr./No. KPD/1219/24

Nr.i fai/Br.stt./Nr.pg.
13/12/2024

Data/Datum/Date:



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

OPINION

R.nr.151/2024

Në lidhje me detyrimet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për të vepruar në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Drejtuar:

Prof. dr. Arben Hajrullahu, Rektor
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Z. Altin Sahiti, Kryesues
Këshilli Drejtues
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Prishtinë, 13 dhjetor 2024

Qëllimi

1. Përmes këtij opinioni Avokati i Popullit do të ofrojë qëndrimin e përgjithshëm lidhur me detyrimet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, që gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive të vepojë në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.

Baza ligjore e veprimit të Avokatit të Popullit

2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 1, përcakton: “*Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.*”
3. Neni 135, paragrafi 3, përcakton: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”
4. Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ndër të tjerash përcakton këto kompetenca dhe përgjegjësi për Avokatin e Popullit: “*Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtresë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.*” (Neni 16.4); si dhe: “*T’i publikojë njofimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.*” (Neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6).
5. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 9 [Avokati i Popullit], paragrafi 1, përcakton: “*Avokati i Popullit është Institucion i shtetit, i cili bënë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit.*”

Rrethanat e rastit

6. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 1 shkurt 2024 kishte pranuar ankesë nga z. Arjan Janova, parashtruar kundër Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” (më tej referuar si: UP), lidhur me pretendimin për cenim të së drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit, si dhe për trajtim të pabarabartë dhe diskriminim në procesin e themelimit të marrëdhënieς së punës në UP.
7. Në bazë të pohimeve të ankuesit dhe të dokumentacionit që Institucioni i Avokatit të Popullit e kishte në dispozicion, vërehej se UP-ja, në kuadër të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 173, paragrafi 4, të Statutit të UP-së, e në përputhje me Ligjin nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë, si dhe me Rregulloren nr. 886 për Procedurat Përçgjedhëse lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik, më 31 maj 2023 kishte shpallur Konkurs publik nr.1/331, për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në fakultetet e UP-së. Ankuesi, duke u bazuar në pikën 1 të konkursit, kishte aplikuar për pozitën nr.13: “*Një asistent për lëndët: Histori e Evropës Juglindore II (O). Historia publike, menaxhimi i programeve për ruajtjen e historisë (O),*

Rregullimi dhe përpunimi i lëndës arkivore(O), Arkivistikë-teori dhe praktikë(O), Legjislacion arkivor (Z), Histori e qytetërimit (O), Metodologji e historisë(O) dhe Histori e qytetërimit modern (O), për të cilën pozitë kishin aplikuar edhe 4 kandidatë të tjera.

8. Në këtë drejtim, Fakulteti Filozofik, pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, kishte publikuar Raportin në buletinin e UP-së, në të cilin ankuesi ishte përzgjedhur si kandidat i suksesshëm dhe atë së bashku me propozimet me kandidatët e përzgjedhur e kishte dërguar në Zyrën për Çështje Akademike në Rektoratin e UP-së, e cila zyre nuk kishte gjetur shkelje në pozitën për të cilën ankuesi ishte përzgjedhur.
9. Më tej ankuesi kishte njoftuar se më 21 nëntor 2023, Rektori i ishte drejtuar Këshillit të Etikës me kërkesë për shqyrtimin e integritetit akademik të ankuesit. Ankuesi pretendon se një kërkesë e tillë ishte bërë vetëm për të dhe jo edhe për dhjetëra kandidatë të tjera të cilët ishin përzgjedhur në këtë procedurë rekrutuese.
10. Më 22 janar 2024, Këshilli i Etikës kishte nxjerrë Vendim nr.159, me të cilin i kishte rekomanduar Senatit akademik: “*Të ketë në konsideratë faktin se reputacioni dhe kredibiliteti i Universitetit do të rrezikohej seriozisht, nëse në procesin e rekrutimit të stafit akademik abstrahohet në tërësi përshtatshmëria etike dhe e kaluara e dyshimtë e kandidatëve, sidomos nëse kjo e kaluar konsiderohet në raport me Universitetin.*”
11. Më 27 shkurt 2024, Senati i UP-së kishte nxjerrë Vendim nr.647, me të cilin e kishte refuzuar emërimin e ankuesit/kandidatit në thirrjen akademike “Asistent për lëndët Histori e Evropës Juglindore II (O), Historia publike, menaxhimi i programeve përruajtjen e historisë (O), Rregullimi dhe përpunimi i lëndës arkivore(O), Arkivistikë-teori dhe praktikë(O), Legjislacion arkivor (Z), Histori e qytetërimit (O), Metodologji e historisë(O) dhe Histori e qytetërimit modern (O).
12. Ankuesi kishte bërë kërkesë për qasje në procesverbalin e takimit të Këshillit të Etikës të datës 22 janar 2024, e cila kërkesë ishte refuzuar nga UP-ja. Pas refuzimit të kërkesës për qasje në dokumentin e kërkuar, ankuesi i ishte drejtuar me ankesë Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), dhe pas vendimit të AIP-së, kërkesa për qasje ishte realizuar.

Vlerësimi i Avokatit të Popullit

13. Avokati i Popullit, duke e ditur se Konkursi publik nr.1/331 për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në fakultetet e UP-së ishte shpallur më 31 maj 2023, sa kishte qenë në fuqi Statuti i UP-së, i miratuar më 12 tetor 2012 (tani Statut jo në fuqi), Statuti i ri i UP-së kishte hyrë në fuqi më 11 korrik 2024 (i publikuar në Gazetën Zyrtare më 17 korrik 2024), konsideron se për çështjen në fjalë do t'i referohet Statutit të UP-së të miratuar më 12 tetor 2012.
14. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh rrethanat e theksuara më sipër, thekson se Statuti i UP-së, i cili paraqet aktin më të lartë juridik të këtij institucioni, në nenin 7 përcakton se UP-ja: “*Obligohet që të krijojë mundësi të barabarta për të gjithë pa asnje lloj diskriminimi...[...] apo ndonjë status tjetër.*” Avokati i Popullit konsideron se në fryshtë e kësaj dispozite duhet të jenë të gjitha aktet e tjera të nxjerra nga UP-ja.
15. Më tej Avokati i Popullit ka vërejtur se Statuti i UP-së,
 - nen 9, përcakton: “*Stafi akademik dhe administrativ i Universitetit dhe studentet*

duhet të sillen në përputhje me standardet më të larta të përkushtimit, integritetit, objektivitetit, përgjegjësisë, sinjeritetit, ndershmërisë dhe udhëheqjes.”

- neni 47, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, përcakton:
 1. *Pavarësish nga përgjegjësitë e Këshillit drejtues dhe Rektorit, Senati është përgjegjës për:*
[...]
1.3. *Miratimin e propozimeve nga Këshilli i Fakultetit për zgjedhjen dhe avansimin e personelit akademik.*
 - neni 173 i Statutit të UP-së përcakton procedurën e emërimit të personelit akademik:
“1. Personeli akademik do të emërohet nga rektori sipas vendimit të Senatit i bazuar në propozimin e këshillit të njësisë akademike.
2. Nëse propozimi refuzohet, ai i kthehet për rishqyrtim këshillit të njësisë akademike.
3. Nëse këshilli i njësisë akademike edhe pas rishqyrtimit sjellë të njëjtin propozim, Senati merr vendim përfundimtar.
4. Procedurat për emërim do të bëhen në mënyrë transparente me shpalljen e konkursit publik për postin.
5. Te gjitha emërimet bëhen pasi t'i shqyrtojë dokumentacionin e aplikimit komisioni vlerësues i formuar nga këshilli i njësisë akademike me propozimin e degës – departamentit. Komisioni vlerësues bënë vlerësimin e kandidateve të cilët konsiderohen që kanë përbushur kushtet për postin e ofruar.
6. Komisioni vlerësues i raporton këshillit që e ka formuar, në afat të caktuar.
7. Askush nuk mund të jetë anëtarë i komisionit vlerësues nëse është bashkëshort, partner ose anëtarë i familjes së ngushtë të kandidatit që duhet të emërohet.
8. Çështje tjera për procedurat vlerësuese përcaktohen me rregullat e nxjerra nga Senati në pajtim me këtë Statut.”
 - neni 174, përcakton: “*Kushtet për emërimin dhe avancimin në çfarëdo titulli të personelit akademik janë kualifikimet përkatëse dhe përvojat relevante për vendin e punës.*”
 - neni 185, përcakton: “*Personeli akademik i Universitetit është i obliguar të respektojë: 1.1. Frymën e humanizmit; 1.2. Autonominë e Universitetit; 1.3. Lirinë e kreativitetit shkencor dhe artistik; 1.4. Aktet universitare dhe vendimet e bazuara në to; 1.5. Parimet e ndershmërisë profesionale dhe shkencore; 1.6. Kodin etik; 1.7. Reputacionin e universitetit dhe ta përmirësoj atë.*”
16. Më tej Avokati i Popullit vëren se Rregullorja nr. prot.886 për Procedurat e Përzgjedhjes lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”(më tutje: Rregullorja nr.886), e datës 27.4.2022, i përcakton procedurat përzgjedhëse dhe procesin për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, në thirrjen *profesor i rregullt, profesor i asociuar, profesor asistent, asistent* dhe *lektor* në të gjitha fakultetet, përveç Fakultetit të Arteve, përkatësisht pozitave që i takojnë fushës së arteve.
17. Për më tepër, Avokati i Popullit vëren se procedura për çështjen në fjalë kishte shkuar sipas Rregullores nr. 886, deri në momentin kur Zyra për Çështje Akademike në Rektorat

kishte bërë vlerësimin dhe shqyrtimin e propozimit të kandidatëve të përzgjedhur nga Fakulteti Filozofik.

18. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh faktin se procedura e përzgjedhjes lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personeli akademik në UP është qartë e përcaktuar me Rregulloren 886, ndërsa emërimi i personelit akademik përcaktohet edhe me nenin 171 të Statutit të UP-së, konsideron se Rektori në rastin kur i ishte drejtuar Këshillit të Etikës me kërkesë për shqyrtimin e integritetit akademik të ankuesit, kishte vepruar jashtë kompetencave të përcaktuara me Statutin e UP-së dhe në kundërshtim me Rregulloren nr.886. Për më tepër, një kërkesë e tillë ishte bërë vetëm për ankuesin dhe jo edhe për dhjetëra kandidatë të tjerë të cilët ishin përzgjedhur në këtë procedurë rekrutuese.
19. Rrjedhimisht, bazuar në nenin 173 të Statutit të UP-së, personeli akademik do të emërohet nga rektori sipas vendimit të Senatit, i bazuar në propozimin e këshillit të njësisë akademike. Nëse propozimi refuzohet, ai i kthehet për rishqyrtim **këshillit të njësisë akademike**. Ndërsa, nëse këshilli i njësisë akademike edhe pas rishqyrtimit e sjell të njëjtin propozim, Senati merr vendim përfundimtar. Të gjitha emërimet bëhen pasi të shqyrtohet dokumentacioni i aplikimit nga komisioni vlerësues i formuar nga këshilli i njësisë akademike me propozimin e degës – departamentit.
20. Avokati i Popullit, duke marrë parasysh faktin se ankuesi nuk ka qenë dhe nuk është i punësuar në UP dhe nuk është student, vlerëson se kërkesa e Rektorit drejtuar Këshillit të Etikës ishte shkelje e procedurave të përcaktuara me Rregulloren 886. Këtë vlerësim Avokati i Popullit e mbështet në përcaktimet e Kodit të Etikës (nr.prot.1/751, datë 19.7.2013), i cili në nenin 3 e përcakton fushëveprimin e këtij kodit dhe i cili zbatohet për gjithë stafin akademik të punësuar në UP, pavarësisht nga forma dhe lloji i kontratës së punës, niveli i emërimit, duke përfshirë por jo duke u kufizuar edhe për pozitën *lektor, asistent, profesor asistent, profesor i asociuar* dhe *profesor i rregullt*. Pra nuk aplikohen dispozitat e Kodit të Etikës së UP-së për kandidatët në procedurën e përzgjedhjes/rekrutimit të stafit akademik.
21. Për më tepër, edhe Statuti i UP-së në nenin 9 përcakton: “*Stafi akademik dhe administrativ i Universitetit dhe studentet duhet të sillen në përputhje me standarde më të larta të përkushtimit, integritetit, objektivitetit, përgjegjësisë, sinjeritetit, ndershmërisë dhe udhëheqjes.*” Pra nuk bëhet fjalë për kandidatët në procedurën e përzgjedhjes/rekrutimit të stafit akademik.
22. Avokati i Popullit thekson se as Rregullorja nr.886 nuk përmban asnjë dispozitë që e rregullon çështjen e kredibilitetit apo të integritetit të personave pjesëmarrës në procedurën e përzgjedhjes për staf të UP-së. Megjithatë, çështja e integritetit për kandidatët në procedurën e përzgjedhjes, e të cilët nuk janë të punësuar në UP, vlerësohet me paraqitjen e dëshmisë nga gjykata kompetente se kandidati nuk është nën hetime dhe se nuk është i dënuar. Një dëshmi e tillë është e renditur te **Kushtet e përgjithshme të konkursit të shpallur, pika II. - Dokumentet e nevojshme për aplikim, pika j)**, të përcaktuara në Konkursin publik nr.1/331, më 31 maj 2023, për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në fakultetet e UP-së.
23. Avokati i Popullit vlerëson se veprimet e Rektorit, vendimi i Këshillit të Etikës dhe përfundimisht vendimi i Senatit, përvçe se vendosin ankuesin në pozitë të pabarabartë, ato përbëjnë edhe diskriminim sipas përcaktimeve të nenit 1 të Ligji nr. 05/L-021 për

Mbrojtje nga Diskriminimi: “*[...] Jufimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, [...] ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.*”

24. Po ashtu, Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi përcakton: “*Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilësdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.*” (neni 3, par. 1), ku në listën e këtyre “bazave të përcaktuara” përfshihet si kategori e hapur “ose ndonjë bazë tjetër” (neni 1, par. 1).
25. Për më tepër, interpretimi i konceptit kushtetues të diskriminimit, duhet marrë parasysh nenin 53 i Kushtetutës, i cili udhëzon: “*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*” (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNj).
26. Sipas vendimeve gjyqësore të GjENDJ-së: “[E] drejta [...] për të mos u diskriminuar [...] shkelet kur Shtetet trajtojnë në mënyrë jo të barabartë persona në situata të ngashme pa dhënë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.” (Thlimmenos v. Greece, Aplikimi Nr. 34369/97, GjEDNj, 6 prill 2000, par. 44). Në mënyrë që një justifikim i tillë të jetë “objektiv dhe i arsyeshëm”, ai duhet t’i plotësojë dy kushte të mëtejshme: 1) duhet të ketë një “qëllim legitim” për pabarazinë në fjalë dhe 2) duhet të ketë një “lidhje të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjetit të përdorur dhe qëllimit të synuar”.
27. Njësoj si vendimet gjyqësore të GjEDNj-së, Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi përcakton se një trajtim jo i barabartë mund të justifikohet nëse ka “një qëllim legitim dhe ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të synuar” (neni 6).
28. Në rastin konkret, kërkesa e Rektorit drejtuar Këshillit të Etikës, për shqyrtimin e integritetit akademik të ankuesit dhe jo të kandidatëve të tjera të përzgjedhur në të njëjtën procedurë rekrutuese, është kërkesë arbitrale dhe e vendos ankuesin në pozitë të pabarabartë në raport me kandidatët e tjera, rrjedhimisht një veprim i tillë përbën diskriminim.
29. Për më tepër, kërkesa e Rektorit nuk ka një qëllim legitim për pabarazinë në fjalë, sepse rregullat e përzgjedhjes së kandidatëve janë të përcaktuara qartë dhe nuk lënë hapësirë për keqinterpretim, si dhe nuk ka lidhje të arsyeshme për qëllimin e synuar.
30. Diskriminimi ndaj ankuesit ka vazhduar me veprimin e Këshillit të Etikës, që rezultoi me Vendimin nr. 159, me të cilin ky Këshill i rekomandoi Senatit të UP-së që ta ketë në konsideratë reputacionin dhe kredibilitetin e UP-së nëse abstrahohet e kaluara e dyshimtë e kandidatëve. Po ashtu, Këshilli i Etikës në këtë vendim theksoi se organet vendimmarrëse në proces të rekrutimit nuk e kanë marrë parasysh nenin 185 të Statutit të UP-së, me theks nenet 6, 13 dhe 14, dhe se ky nen duhet të merret në konsideratë edhe për kandidatët e paraqitur në konkursin publik.
31. Avokati i Popullit vëren se neni 185 i Statutit të UP-së i përcakton obligimet e personelit akademik të UP-së sikurse edhe Kodi i Etikës, i cili zbatohet për gjithë stafin akademik të punësuar në UP, pavarësisht nga forma dhe lloji i kontratës së punës. Ndërsa ankuesi nuk është i punësuar i UP-së.

32. Këshilli i Etikës në këtë vendim është lëshuar në interpretimin e një vendimi gjyqësor të një lënde penale, ku pjesë e hetimit ka qenë edhe ankuesi gjatë kohës kur ai ka qenë student, por që ankuesi është liruar me **Aktgjykim të formës së prerë** (PAKR nr.402/2017). Për më tepër, dy nga personat që përmenden në këtë aktgjykim, janë të punësuar në UP (E.B. dhe G.M), e të cilët në kohën kur kanë qenë akuzuar për veprën që bëhet fjalë në aktgjykim, kanë qenë studentë. Pra, ankuesi është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe është diskriminuar në raport me persona të tjerë në situatë të njëjtë dhe përvçese një vendim i tillë është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, me Statutin e UP-së dhe me Rregulloren nr.886, është në kundërshtim edhe me vetë pohimet e Këshillit të Etikës për praktikën vendimmarrëse të saj kur i referohet kredibilitetit dhe reputacionit të UP-së. Avokati i Popullit vëren se trajtimi i pabarabartë dhe diskriminues ndaj ankuesit ka vazhduar edhe me Vendimin e Senatit (Vendimi nr. prot. 647, datë 27.2.2024).
33. Rrjedhimisht, nisur nga interpretimi i nenit 1 të Protokollit 12, i cili shtrin fushën e mbrojtjes për “**çdo të drejtë të parashikuar nga ligji**” dhe vendos një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit, që nënkupton situata kur çështja bie në fushën e veprimit të një të drejte substanciale të garantuar nga ligji i brendshëm, edhe çështja e vendosjes së kriterit përfshirë të kandidatëve që i kanë kryer studimet në UP bie në fushën e një të drejte të rregulluar me ligj.

Përfundim

34. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh rrëthanat e theksuara më sipër, vlerëson se Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, përmes akteve (Statutit dhe Rregullores nr. 886) ka përcaktuar procedurat e përzgjedhjes lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.
35. Lidhur me rastin konkret, Avokati i Popullit, duke pasur parasysh rrëthanat e theksuara më sipër si dhe bazën ligjore, konsideron se në rastin e ankuesit UP-ja nuk i ka zbatuar procedurat sipas përcaktimeve të Statutit dhe as të Rregullores nr. 886.
36. Si rezultat i mosrespektimit të procedurave sipas akteve të theksuara më sipër, Avokati i Popullit vlerëson se në rastin konkret ankuesi është vënë në pozitë të pafavorshme gjatë procesit të rekrutimit në UP.
37. Për më tepër, Avokati i Popullit konsideron se veprimet e UP-së të ndërmarra ndaj ankuesit me rastin e procedurës së zgjedhjes së personelit akademik tregojnë për trajtim të pabarabartë ndërmjet personave në situata të ngjashme dhe diskriminues në kuptim të nenit 1, paragrafi 1, dhe të nenit 3, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
38. Avokati i Popullit thekson se UP-ja, përvëç zbatimit të gjitha ligjeve të tjera të cilat janë në fuqi dhe që i zbaton në veprimtarinë e përditshme, e ka obligim të veprojë në përputhje të plotë me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.
39. Në fund, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” se mosrespektimi i akteve të brendshme sipas qëllimit dhe fushëveprimit të tyre, e po ashtu moszbatimi i parimeve të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, shpie në

shkelje të të drejtave të njeriut, respektivisht në diskriminim, siç është rasti i ankuesit lidhur çështjen në fjalë.


Me nderime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit